



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 01, datë 23.10.2019

**PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1 datë 14.04.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë”, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97 datë 26.08.2019, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tiranë, pjesë e të cilit është dokumenti i mëposhtëm:
 - *Dokumenti i Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë.*
2. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Tiranë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR/ SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA PËR ZHVILLIMET NË TERRITOR

Nr. 1073/₂ Prot.

Tiranë, më 18 . 06 .2020

Lënda: Dërgohet Vendimin Nr. 01, datë 23.10.2019 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”.

BASHKISË TIRANË —

ARKIVIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 23.10.2019, ka marrë Vendimin Nr. 01 “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”, në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Vendimi është sigluar nga Sekretar i KKT-së, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nga Kryetari i KKT-së.

Bashkëlidhur Ju lutem gjeni dokumentacionin si më poshtë.

- **Vendimin Nr. 01, datë 23.10.2019** “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”.
- **Dokumenti i Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ledia TOFA

